

10. Covid-19

Për të ruajtur qytetarët që takohen me SARS-CoV-2 ASL ka vënë në dispozicion një shërbim contact tracing që shpërndan informacionet e nevojshme personave të interesuar: një operator sanitar telefonon pacientet për tu informuar mbi gjendjen e tyre shëndetësore, për ti shpjeguar se si duhet të sillen dhe ç'farë rregullash duhet të ndjek.

Nëse një qytetar ka nevojë për një vizitë mjeksore për një infektim apo për dyshim për infektim nga SARS-CoV-2, dhe kështu nuk mund të dalë nga shtëpia, mund të përfitojë nga shërbimi USCA (Unità Speciali di Continuità Assistenziale), një grup operatorësh mjeksor që i dedikohet COVID-19.

Në rast simptomash të ngjashme me të gripit (kollë, dhimbje grykësh, temperaturë) këshillohet konsultimi me mjekun e familjes (MMD/Pdf, mjekut roje ose mjekut të ambulatorit STP) që do tju udhëzojë mbi marrjen përsipër dhe aktivizimin e rrugëzimit më të përshtatshëm sipas rastit.

Vaksinimi anti-Sars Cov-2/COVID-19

Edhe në mungesë të regjistrimit në SSN, është i mundur vaksinimi anti-Sars Cov2, duke iu drejtuar mjekut të familjes, pediatrit, mjekut roje ose mjekut të ambulatorit STP, për informacione mbi rrugëzimin që duhet ndjekur sipas rastit.

GREEN PASS

Si duhet të veprojmë për të pasur Green Pass nëse jam vaksinuar jashtë Italisë? diq linkun:

<https://www.uslcentro.toscana.it/index.php/maxiemergenze-crm/emergenza-covid-maxiemergenza-regionale>

Është e nevojshme të shkohet në qendrat e shënuara më poshtë.

Është e mjaftueshme të paraqiten dokumentat e vaksinimeve të kryera.

- Qendra e Santa Rosa
E hënë, e mërkurë dhe e enjte: nga ora 8.00 deri në 12.30
- Qendra shëndetësore Morgagni
E hënë, e mërkurë, e enjte dhe e premte: nga ora 8.00 deri në 12.30
- Qendra D'Annunzio
E hënë, e mërkurë, e enjte dhe e premte: nga ora 8.00 deri në 12.30

Përndryshe është e mundur telefonimi në 055-545454 dhe të flasësh me URP.